



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:900715

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05506855

**C.nr.1332/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i Përgjithshëm gjyqtari Shaban Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit J.G. nga Prizreni, kundër të paditurve V.H. nga Prizreni të cilën e përfaqëson av.Y.K., D.A. me banim në Prishtinë dhe K.Ç. nga Prizreni rr.Rrustem Avniu nr.14 për shkak të vërtetimit të pronësisë më datën 26.03.2024, mori këtë:

#### **A K T V E N D I M**

**I.NDËRPRITET** procedura në këtë çështje juridike kontestimore për shkak të vdekjes së palëve **J.G. (paditësit)** dhe **K.Ç. (të paditues)**.

Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e palëve e marrin përsipër procedurën apo kur gjykata të vlerëson ndryshe.

#### **A r s y e t i m**

Paditësi J.G. nga Prizreni, në këtë gjykatë ka parashtuar padi kundër të paditurve V.H. nga Prizreni të cilën e përfaqëson av.Y.K., D.A. me banim në Prishtinë dhe K.Ç. nga Prizreni për shkak të vërtetimit të pronësisë.

Gjykata lidhur më këtë çështje ka caktuar shqyrtimin përgatitor më dt.26.03.2024 në të cilën ka prezantuar i autorizuari i të paditurës V.H. av.Y.K. dhe djali i paditësit D.G. i cili njofton gjykatën se babai ka vdekur dhe si provë dorëzon certifikatën e vdekjes më nr.rendor 853 nga e cila vërtetohet fakti se paditësi ka vdekur në Prizren më dt.17.09.2020. Gjithashtu ka njoftuar se e paditura K.Ç. ka vdekur dhe si provë ka dorëzuar certifikatën e vdekjes më nr.rendor 384 nga e cila vërtetohet fakti se e paditura ka vdekur në Prizren më dt.15.03.2022, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 277 par.1 pika (a) e lidhur më nenin 280 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**-Departamenti i pergjithshëm-**

**C.nr.1332/21, dt.26.03.2024**

**Gjyqtari**  
Shaban Shala

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.